

UNIVERSITETI METROPOLITAN TIRANA

RAPORTI I VLERËSIMIT INSTITUCIONAL NGA PERSONELI AKADEMIK

VITI AKADEMIK: 2023-2024

Përgatitur nga : Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC)
Periudha e vlerësimit : 03 - 14 qershor 2024
Data e publikimit : 7 Tetor, 2024
Numri i pjesëmarrësve : 47 anëtarë të personelit akademik
Lloji i instrumentit : Formular për vlerësimin e institucionit nga personeli akademik (Paketa e instrumenteve të cilësisë)

Objektivi: Analiza e perceptimeve të stafit akademik *mbi aspekte të ndryshme të administrimit, mjedisit të punës, dhe mbështetjes institucionale për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë.*

Përmbajtja

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	4
Metodologjia.....	4
Analizë e të dhënave.....	5
Kategoria e stafit akademik.....	5
Eksperienca e punës së stafit akademik.....	5
INFRASTRUKTURA FIZIKE DHE TEKNOLOGJIKE E INSTITUCIONIT.....	7
Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës.....	7
Niveli i sigurisë fizike dhe mbrojtjes në institucion.....	8
Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë në institucion.....	9
Hapësira në vendin e punës dhe mësimdhënies.....	10
Infrastruktura teknologjike e institucionit.....	11
Numri i studentëve në klasa.....	12
Mundësitë për shërbime sociale dhe mirëqenie.....	13
Përshkrimi i detyrave të personelit akademik.....	14
Respektimi i kushteve kontraktuale nga institucioni.....	15
Aksesueshmëria e procedurave për adresimin e ankesave.....	16
Qartësia dhe transparenca e procesit të vlerësimit të performancës akademike.....	17
Liria e shprehjes së mendimeve nga personeli akademik.....	18
Mbështetja e ideve dhe kontributeve të reja nga personeli akademik.....	19
Përfshirja e personelit akademik në proceset vendimmarrëse.....	20
Përputhja e detyrave me fushën akademike.....	21
Balanca ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit.....	22
Ndikimi i detyrave administrative në angazhimet akademike.....	23
Vlerësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike të institucionit.....	24
SHËRBIMET DHE MBËSHTETJA AKADEMIKE E INSTITUCIONIT.....	25
Mbështetja administrative për përmbushjen e detyrave.....	25
Mjaftueshmëria e personelit administrativ për mbështetjen institucionale.....	26
Efektiviteti i punës së sekretarisë së njësive përkatëse.....	27
Mjedisi i qëndrueshëm i punës dhe siguria për vazhdimësinë e angazhimit akademik.....	28
Atmosfera e përgjithshme e punës në institucion.....	29
Bashkëpunimi konstruktiv dhe i kënaqshëm me kolegët.....	30
Përdorimi i ekspertizës profesionale të personelit akademik.....	31
Mbështetja për pjesëmarrjen e personelit akademik në veprimtari akademike.....	31
Burimet dhe infrastruktura për kërkimin shkencor brenda institucionit.....	33
Rëndësia e programeve të shkëmbimit për personelin akademik dhe studentët.....	34
Aksesi i studentëve për komunikim me stafin akademik.....	35
Niveli akademik dhe përkushtimi i studentëve në procesin e mësimdhënies.....	36
Vlerësimi i shërbimeve dhe mbështetjes akademike të institucionit.....	37
VIZIONI DHE STRATEGJIA INSTITUCIONALE.....	38
Njohja e vizionit dhe misionit institucional.....	38
Përputhja e programeve të studimit me interesat dhe nevojat kombëtare.....	39
Profesionalizmi dhe integriteti në drejtimin e institucionit.....	40
Rëndësia e prezantimit kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit.....	41
Perceptimi i UMT si një institucion i qëndrueshëm për zhvillimin e karrierës akademike afatgjatë.....	42
Sugjerimi i UMT si një mundësi për zhvillimin e karrierës akademike.....	43
Përfshirja e personelit akademik në zhvillimin e strategjive afatgjata.....	44
Vlerësimi i vizionit dhe strategjisë institucionale.....	45
Analiza e përgjigjeve për aspektet kryesore që japin kënaqësi në punën e stafit akademik të UMT-së.....	46

Analiza e përgjigjeve për elementet që ndihmojnë në rritjen e motivimit në UMT	47
Analiza e përgjigjeve për faktorët që mund të motivojnë stafin për të kërkuar mundësi të reja karriere jashtë UMT	48
Analiza e përgjigjeve për përmirësimin e administrimit në UMT	49

Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të gjetjeve nga procesi i vlerësimit institucional të Universitetit Metropolitan Tirana (UMT), bazuar në përgjigjet e dhëna nga personeli akademik. Ky vlerësim është një instrument thelbësor për të kuptuar perceptimet, kënaqësinë dhe nevojat e stafit, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi aspektet që funksionojnë mirë dhe ato që kërkojnë përmirësim brenda institucionit.

Procesi i vlerësimit, i administruar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), u krye në mënyrë të strukturuar gjatë periudhës 03-14 qershor 2024. Përmes pyetësorit të hartuar posaçërisht, janë adresuar tema që përfshijnë mjedisin e punës, mbështetjen institucionale, proceset e menaxhimit dhe aspekte të tjera kyçe që ndihmojnë në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e institucionit.

Rezultatet e këtij procesi kanë një rëndësi të veçantë për të nxitur përmirësimin e mëtejshëm të praktikave institucionale, rritjen e transparencës dhe krijimin e një mjedisi pune më të përshtatshëm dhe motivues për personelin akademik. Ky raport synon të ofrojë rekomandime konkrete bazuar në gjetjet kryesore, duke ndihmuar në hartimin e strategjive për zhvillimin e mëtejshëm të UMT-së.

Metodologjia

Ky vlerësim institucional është realizuar përmes një pyetësori gjysmë të strukturuar, i cili përmban kombinim të pyetjeve të mbyllura dhe të hapura. Pyetësori, pjesë e paketës së instrumenteve të cilësisë të përgatitur nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), u plotësua online përmes platformës Edu4School, duke mundësuar akses të lehtë dhe përpunim të shpejtë në SPSS të të dhënave.

Të dhënat u mblodhën nga 47 anëtarë të stafit akademik, dhe analiza synoi të evidentojë perceptimet e tyre mbi aspekte kyçe të administrimit dhe funksionimit të institucionit. Përmes kësaj qasjeje, u siguria mbledhja e informacioneve të dobishme për vlerësimin e pikave të forta dhe identifikimin e fushave që kërkojnë përmirësim, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në UMT.

Analizë e të dhënave


Kategoria e stafit akademik

Nga të dhënat e grumbulluara rezulton se shumica e stafit akademik në UMT përbëhet nga lektorë (63.8%), ndërsa profesorët përfaqësojnë 21.3% dhe asistent lektorët 14.9%. Kjo shpërndarje reflekton një strukturë të balancuar, ku lektorët luajnë një rol qendror në mësimdhënie dhe aktivitete akademike, ndërsa profesorët kontribuojnë në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe mentorimin e stafit më të ri. **Përfshirja e të gjitha kategorive në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit është thelbësore për të siguruar rritjen dhe avancimin profesional të stafit.**

Kategoria së cilës i përkisni					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Asistent lektor	7	14.9	14.9	14.9
	Lektor	30	63.8	63.8	78.7
	Profesor	10	21.3	21.3	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Kategoria së cilës i përkisni

■ Asistent lektor
■ Lektor
■ Profesor




Eksperiencia e punës së stafit akademik

Të dhënat tregojnë se stafi akademik në UMT ka një gamë të gjerë të eksperiencës profesionale, me shumicën që kanë 11-15 vjet përvojë pune (44.7%). Pjesa e dytë më e madhe përfaqësohet nga ata me mbi 20 vjet përvojë (23.4%), duke pasuar me ata që kanë 1-5 vjet (17.0%) dhe 6-10 vjet përvojë (12.8%). Një pjesë më e vogël, 2.1%, përfaqësohet nga stafi me 16-20 vjet përvojë. **Kjo shpërndarje pasqyron një balancë midis eksperiencës së konsiderueshme dhe potencialit për zhvillim të stafit, duke garantuar një kombinim të ekspertizës dhe energjisë për përmirësimin e mëtejshëm të procesit akademik.**

Eksperienca e punës					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1-5 vjet	8	17.0	17.0	17.0
	11-15 vjet	21	44.7	44.7	61.7
	16-20 vjet	1	2.1	2.1	63.8
	6-10 vjet	6	12.8	12.8	76.6
	Mbi 20 vjet	11	23.4	23.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Eksperienca e punës




INFRASTRUKTURA FIZIKE DHE TEKNOLOGJIKE E INSTITUCIONIT

Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës

Rezultatet tregojnë se të gjithë pjesëmarrësit (100%) e kanë vlerësuar pozitivisht këtë aspekt, me 63.8% që kanë dhënë vlerësimin 4 dhe 36.2% që kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5. Këto shifra reflektojnë një përkushtim të lartë të institucionit ndaj mirëmbajtjes dhe pastërtisë së mjediseve të përbashkëta, duke përmbushur në mënyrë të shkëlqyer standardet institucionale të higjienës. **Vlerësimet unanime pozitive dëshmojnë qartë se pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë një nga pikat shumë të forta të institucionit.**

Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit: Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	4	30	63.8	63.8	63.8
	5	17	36.2	36.2	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit: Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standardet institucionale të higjienës




Infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit: Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta janë në përputhje me standard...

Niveli i sigurisë fizike dhe mbrojtjes në institucion

Niveli i kënaqësisë për sigurinë fizike dhe mbrojtjen që ofron institucioni është reflektuar në vlerësime pozitive nga pjesa më e madhe e stafit. 53.2% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 36.2% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, me një total prej 89.4% vlerësimesh pozitive. Vetëm 10.6% kanë dhënë një vlerësim neutral (3). **Këto rezultate tregojnë se siguria fizike dhe mbrojtja janë konsideruar si një aspekt i fortë dhe i rëndësishëm i institucionit nga shumica dërrmuese e pjesëmarrësve.**

Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	5	10.6	10.6	10.6
	4	25	53.2	53.2	63.8
	5	17	36.2	36.2	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Jam i kënaqur me nivelin e sigurisë fizike dhe të mbrojtjes që institucioni ofron




Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë në institucion

Rezultatet tregojnë një nivel të kënaqshëm të vlerësimit për shërbimet mjekësore dhe ndihmën e parë të ofruar nga institucioni. 51.1% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 17% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke sjellë një total prej 68.1% vlerësimesh pozitive. Nga ana tjetër, 31.9% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), duke sugjeruar hapësirë për përmirësim në këtë fushë. **Rezultatet tregojnë se shumica e pjesëmarrësve janë të kënaqur me nivelin e shërbimeve mjekësore, megjithatë disa fusha mund të analizohen më tej për të përmirësuar më tej kënaqësinë.**

Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	15	31.9	31.9	31.9
	4	24	51.1	51.1	83.0
	5	8	17.0	17.0	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Shërbimet mjekësore dhe ndihma e parë e ofruar në institucion janë në nivelin e duhur




Hapësira në vendin e punës dhe mësimdhënies

Të dhënat tregojnë se shumica e pjesëmarrësve e vlerësojnë pozitivisht hapësirën në vendin e punës dhe mësimdhënies. 53.2% kanë dhënë vlerësimin 4 dhe 25.5% vlerësimin maksimal, 5, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 78.7%. Nga ana tjetër, 21.3% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), duke sugjeruar disa mundësi për përmirësim. **Rezultatet tregojnë se pjesa më e madhe e stafit konsideron hapësirën si të mjaftueshme dhe motivuese, duke mbështetur punën dhe mësimdhënien efektive.**

Hapësira që kam në vendin e punës dhe mësimdhënies është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	10	21.3	21.3	21.3
	4	25	53.2	53.2	74.5
	5	12	25.5	25.5	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Hapësira që kam në vendin e punës dhe mësimdhënies është e mjaftueshme dhe motivuese për punë efektive




Infrastruktura teknologjike e institucionit

Rezultatet tregojnë se infrastruktura teknologjike e institucionit vlerësohet shumë pozitivisht nga pjesëmarrësit. 57.4% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, dhe 34% kanë dhënë vlerësimin 4, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 91.4%. Vetëm 8.5% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), duke treguar se ky aspekt përmbush pritshmëritë e shumicës dërrmuese të stafit. **Këto të dhëna tregojnë se infrastruktura teknologjike moderne e institucionit luan një rol kyç në mbështetjen e mësimdhënies dhe procesit të punës.**

Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem menaxhimi të informacionit)					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	4	8.5	8.5	8.5
	4	16	34.0	34.0	42.6
	5	27	57.4	57.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Institucioni ofron një infrastrukturë teknologjike bashkëkohore (si projektorë, kompjuterë, rrjet interneti, sistem menaxhimi të informacionit)




Numri i studentëve në klasa

Rezultatet tregojnë se të gjithë pjesëmarrësit (100%) e kanë vlerësuar pozitivisht këtë aspekt. 59.6% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, ndërsa 40.4% kanë dhënë vlerësimin

4. Këto të dhëna tregojnë se numri i studentëve në klasa konsiderohet i përshtatshëm, duke mbështetur zhvillimin normal dhe efektiv të procesit të mësimi.

Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimi					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	4	19	40.4	40.4	40.4
	5	28	59.6	59.6	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimi




Numri i studentëve në klasa lejon zhvillimin normal dhe efektiv të mësimi

Mundësitë për shërbime sociale dhe mirëqenie

Rezultatet tregojnë një shpërndarje të larmishme të vlerësimeve për shërbimet sociale të ofruara nga institucioni. 23.4% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, ndërsa 17% kanë dhënë vlerësimin 4, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 40.4%. 55.3% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa 4.3% kanë dhënë vlerësimin 2, duke treguar hapësirë për përmirësim në këtë aspekt. **Rezultatet sugjerojnë se, ndërsa disa pjesëmarrës janë të kënaqur me shërbimet sociale, një numër i konsiderueshëm e percepton këtë fushë si të nevojshme për zhvillim të mëtejshëm për të përmirësuar komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës.**

Institucioni ofron mundësi të përshtatshme për shërbime sociale (si kafene, ngrënie e drekës, mjedise sportive etj.) që lehtësojnë komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	26	55.3	55.3	59.6
	4	8	17.0	17.0	76.6
	5	11	23.4	23.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Institucioni ofron mundësi të përshtatshme për shërbime sociale (si kafene, ngrënie e drekës, mjedise sportive etj.) që lehtësojnë komoditetin dhe mirëqenien gjatë orarit të punës




Përshkrimi i detyrave të personelit akademik

Pjesëmarrësit në vlerësim kanë shprehur një nivel të lartë qartësie dhe kënaqësie lidhur me përshkrimin e detyrave të tyre. 36.2% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, dhe 55.3% vlerësimin 4, duke sjellë një total prej 91.5% vlerësimesh pozitive. Nga ana tjetër, 4.3% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), dhe një pjesë e vogël prej 4.3% ka dhënë vlerësimin 2. **Këto rezultate tregojnë se përshkrimi i detyrave është një pikë e fortë e institucionit, ndërsa një numër i vogël pjesëmarrësish mund të përfitojnë nga qartësime të mëtejshme.**

Roli dhe të drejtat e personelit akademik në institucion: Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	2	4.3	4.3	8.5
	4	26	55.3	55.3	63.8
	5	17	36.2	36.2	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Roli dhe të drejtat e personelit akademik në institucion: Kam përshkrim të qartë të detyrave që më përkasin




Respektimi i kushteve kontraktuale nga institucioni

Vlerësimet e stafit tregojnë një nivel të përgjithshëm kënaqësie lidhur me respektimin e kushteve kontraktuale nga institucioni. 59.6% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 29.8% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 89.4%. Një përqindje e vogël prej 6.4% ka dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa vetëm 4.3% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Këto rezultate tregojnë se shumica dërrmuese e stafit besojnë se institucioni respekton kushtet kontraktuale, megjithëse disa raste individuale mund të kërkojnë vëmendje të mëtejshme.**

Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	3	6.4	6.4	10.6
	4	28	59.6	59.6	70.2
	5	14	29.8	29.8	100.0
	Total	47	100.0	100.0	


Institucioni respekton kushtet kontraktuale lidhur me angazhimin tim



Aksesueshmëria e procedurave për adresimin e ankesave

Rezultatet tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv lidhur me aksesueshmërinë e procedurave për adresimin e ankesave. 55.3% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, dhe 21.3% vlerësimin maksimal, 5, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 76.6%. Nga ana tjetër, 19.1% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa 4.3% kanë dhënë vlerësimin 2, duke treguar disa hapësira për përmirësim. **Këto rezultate sugjerojnë se shumica e pjesëmarrësve i konsiderojnë procedurat për adresimin e ankesave si të aksesueshme, megjithatë, edhe pse në një numër të vogël, ekziston mundësia për të rritur qartësinë dhe efikasitetin e tyre.**

Procedurat për adresimin e ankesave janë të aksesueshme					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	9	19.1	19.1	23.4
	4	26	55.3	55.3	78.7
	5	10	21.3	21.3	100.0
	Total	47	100.0	100.0	




Qartësia dhe transparencia e procesit të vlerësimit të performancës akademike

Rezultatet pasqyrojnë një perceptim kryesisht pozitiv lidhur me procesin e vlerësimit të performancës akademike. 51.1% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 42.6% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 93.7%. Vetëm 2.1% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), dhe një përqindje minimale prej 4.3% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Këto rezultate dëshmojnë se shumica dërrmuese e stafit i konsiderojnë proceset e vlerësimit akademik si të qarta, transparente dhe të bazuara në kritere objektive, megjithëse një pjesë e vogël e tyre (2 nga 47) mund të përfitojnë nga përmirësime të mëtejshme.**

Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kritere objektive					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	1	2.1	2.1	6.4
	4	24	51.1	51.1	57.4
	5	20	42.6	42.6	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kritere objektive




Procesi i vlerësimit të performancës akademike është i qartë, transparent dhe i bazuar në kritere objektive

Liria e shprehjes së mendimeve nga personeli akademik

Të dhënat tregojnë një nivel të lartë kënaqësie në lidhje me lirinë e shprehjes së mendimeve dhe qëndrimeve nga personeli akademik. 48.9% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 44.7% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, me një total prej 93.6% vlerësimesh pozitive. Vetëm 6.4% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), pa asnjë shprehje pakënaqësie. **Rezultatet sugjerojnë se liria e shprehjes është një pikë e fortë e institucionit, duke krijuar një mjedis të favorshëm për mendimin kritik dhe diskutimin profesional.**

Personeli akademik gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	3	6.4	6.4	6.4
	4	23	48.9	48.9	55.3
	5	21	44.7	44.7	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Personeli akademik gëzon liri në shprehjen e mendimeve dhe qëndrimeve të tij




Mbështetja e ideve dhe kontributeve të reja nga personeli akademik

Rezultatet tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv lidhur me mbështetjen dhe inkurajimin e ideve dhe kontributeve të reja nga personeli akademik. 42.6% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, dhe 40.4% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 83%. Nga ana tjetër, 17% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), duke sugjeruar disa hapësira për përmirësim. **Këto rezultate tregojnë se shumica e stafit ndihen të mbështetur në idetë e tyre, megjithëse ekziston potencial për të përforcuar më tej këtë mbështetje.**

Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli akademik					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	8	17.0	17.0	17.0
	4	20	42.6	42.6	59.6
	5	19	40.4	40.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Institucioni mbështet dhe inkurajon idetë dhe kontributet e reja nga personeli akademik




Përfshirja e personelit akademik në proceset vendimmarrëse

Rezultatet pasqyrojnë një shpërndarje të balancuar të vlerësimeve lidhur me nxitjen e përfshirjes së personelit akademik në proceset vendimmarrëse. 36.2% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, dhe 31.9% kanë dhënë vlerësimin 4, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 68.1%. Nga ana tjetër, 27.7% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa vetëm 4.3% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Rezultatet tregojnë se përfshirja në vendimmarrje perceptohet pozitivisht nga shumica, megjithatë ka ende hapësirë për të rritur pjesëmarrjen dhe përfshirjen në këtë aspekt.**

Institucioni nxit përfshirjen e personelit akademik në proceset vendimmarrëse					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	13	27.7	27.7	31.9
	4	15	31.9	31.9	63.8
	5	17	36.2	36.2	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Institucioni nxit përfshirjen e personelit akademik në proceset vendimmarrëse




Përputhja e detyrave me fushën akademike

Të dhënat tregojnë një perceptim të lartë pozitiv lidhur me përputhjen e detyrave të stafit me fushën e tyre akademike. 44.7% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, dhe po aq kanë dhënë vlerësimin 4, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 89.4%. Vetëm 10.6% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), pa asnjë shprehje pakënaqësie. **Këto rezultate sugjerojnë se detyrat e stafit janë të përshtatshme dhe në harmoni me fushën e tyre akademike, duke kontribuar në një përvojë të qëndrueshme dhe profesionale.**

Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	5	10.6	10.6	10.6
	4	21	44.7	44.7	55.3
	5	21	44.7	44.7	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Detyrat e mia janë në përputhje me fushën time akademike




Balanca ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit

Rezultatet tregojnë një perceptim kryesisht pozitiv lidhur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit. 38.3% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, ndërsa 31.9% kanë dhënë vlerësimin 4, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 70.2%. Nga ana tjetër, 25.5% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), dhe një përqindje minimale prej 4.3% ka shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Këto rezultate tregojnë se shumica e stafit janë të kënaqur me balancën e detyrave të tyre, megjithatë disa raste individuale mund të përfitojnë nga një rishikim i mundshëm i prioriteteve.**

Jam i kënaqur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	12	25.5	25.5	29.8
	4	15	31.9	31.9	61.7
	5	18	38.3	38.3	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Jam i kënaqur me balancën ndërmjet kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe shërbimit ndaj komunitetit




Ndikimi i detyrave administrative në angazhimet akademike

Rezultatet tregojnë se përfshirja në detyra administrative perceptohet kryesisht si një faktor që ndikon në kohën dhe energjinë për angazhimet akademike. 40.4% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, dhe 38.3% kanë dhënë vlerësimin 4, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 78.7%. Një përqindje prej 19.1% ka dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa vetëm 2.1% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Këto rezultate sugjerojnë se shumica e stafit ndiejnë një ndikim të moderuar të detyrave administrative, megjithatë balanca ndërmjet këtyre detyrave dhe angazhimeve akademike mund të përmirësohet më tej për të rritur efektivitetin e punës.**

Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	1	2.1	2.1	2.1
	3	9	19.1	19.1	21.3
	4	18	38.3	38.3	59.6
	5	19	40.4	40.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike



Përfshirja ime në detyra administrative ndikon në kohën dhe energjinë që mund t'i përkushtoj angazhimeve akademike

Vlerësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjike të institucionit

Pikat e forta

Rezultatet e analizës pasqyrojnë një nivel të lartë kënaqësie në shumicën e aspekteve që lidhen me infrastrukturën fizike dhe teknologjike të institucionit. **Pastërtia dhe mirëmbajtja e mjediseve të përbashkëta** kanë marrë një vlerësim unanim pozitiv (100%), duke reflektuar përkushtimin e institucionit për të ruajtur standardet e higjienës dhe komoditetit për të gjithë përdoruesit. **Infrastruktura teknologjike** ka rezultuar gjithashtu një pikë shumë e fortë, me 91.4% të pjesëmarrësve që kanë shprehur kënaqësi të lartë për aksesin në pajisje moderne si projektorët, kompjuterët, rrjetin e internetit dhe sistemet e menaxhimit të informacionit, duke mbështetur një proces të efektshëm mësimdhënieje dhe menaxhimi akademik.

Gjithashtu, **hapësirat e punës dhe të mësimdhënies** janë vlerësuar pozitivisht nga shumica dërrmuese (78.7%), duke krijuar një ambient të përshtatshëm dhe motivues për stafin akademik dhe studentët. **Siguria fizike dhe mbrojtja** që ofron institucioni ka marrë një total prej 89.4% vlerësimesh pozitive, duke theksuar një mjedis të sigurt dhe të besueshëm për punë. Për më tepër, procedurat për adresimin e ankesave dhe përshkrimi i qartë i detyrave kanë marrë gjithashtu vlerësime të larta, duke kontribuar në qartësi dhe mirëfunksionim të strukturës institucionale.

Rekomandime

Pavarësisht këtyre pikave të forta, disa fusha mund të përmirësohen më tej për të adresuar pritshmëritë e të gjithë stafit. **Shërbimet sociale** (si kafeneja, ngrënia e drekës dhe mjediset sportive) kanë marrë një vlerësim më të ulët, me 55.3% të pjesëmarrësve që kanë dhënë një vlerësim neutral ose më të ulët. Kjo sugjeron nevojën për të rritur cilësinë ose aksesin në këto shërbime, duke përmirësuar mirëqenien dhe komoditetin gjatë orarit të punës. Gjithashtu, **balanca ndërmjet detyrave administrative dhe akademike** mbetet një çështje për disa pjesëmarrës, duke theksuar nevojën për të rishikuar ngarkesën administrative dhe për të siguruar një ndarje më të drejtë të kohës dhe energjisë.

Në përgjithësi, infrastruktura fizike dhe teknologjike e institucionit përfaqëson një nga asetet më të forta të tij, me rezultate shumë pozitive në shumicën e kritereve të analizuara. Përmirësimet në disa fusha do të ndihmojnë në arritjen e një përvojë akoma më të mirë për stafin dhe studentët.


SHËRBIMET DHE MBËSHTETJA AKADEMIKE E INSTITUCIONIT

Mbështetja administrative për përmbushjen e detyrave

Rezultatet tregojnë një nivel të kënaqshëm të mbështetjes administrative të ofruar nga institucioni. 57.4% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, ndërsa 21.3% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 78.7%. Nga ana tjetër, 21.3% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), pa asnjë shprehje pakënaqësie. **Këto të dhëna sugjerojnë se shumica e stafit janë të kënaqur me mbështetjen administrative të ofruar, megjithatë mund të ekzistojë potencial për të adresuar më mirë nevojat e disa individëve.**

Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit: Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	3	10	21.3	21.3	21.3
	4	27	57.4	57.4	78.7
	5	10	21.3	21.3	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit: Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave të mia




Shërbimet dhe mbështetja akademike e institucionit: Institucioni më ofron mbështetjen administrative të nevojshme për përmbushjen e detyrave ...

Mjaftueshmëria e personelit administrativ për mbështetjen institucionale

Të dhënat tregojnë se shumica e pjesëmarrësve e vlerësojnë pozitivisht mjaftueshmërinë e personelit administrativ për të përmbushur nevojat e institucionit. 53.2% kanë dhënë vlerësimin 4 dhe 25.5% vlerësimin maksimal, 5, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 78.7%. Nga ana tjetër, 14.9% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), dhe një përqindje minimale prej 6.4% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin 2. **Rezultatet tregojnë se shumica e stafit janë të kënaqur me numrin e personelit administrativ, megjithëse disa individë mund të perceptojnë nevojën për rritje të kapaciteteve për të adresuar më mirë disa kërkesa specifike.**

Numri i personelit administrativ është i mjaftueshëm për të mbështetur nevojat e institucionit					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	3	6.4	6.4	6.4
	3	7	14.9	14.9	21.3
	4	25	53.2	53.2	74.5
	5	12	25.5	25.5	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Numri i personelit administrativ është i mjaftueshëm për të mbështetur nevojat e institucionit




Efektiviteti i punës së sekretarisë së njësive përkatëse

Rezultatet tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv lidhur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive. 48.9% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4 dhe 31.9% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 80.8%. Nga ana tjetër, 14.9% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa vetëm 4.3% kanë shprehur pakënaqësi me vlerësimin

2. Këto të dhëna tregojnë se shumica e stafit janë të kënaqur me punën e sekretarisë së njësive, megjithatë ekziston mundësia për përmirësime të mëtejshme në disa aspekte për të adresuar pritshmëritë e të gjithë stafit.

Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	2	4.3	4.3	4.3
	3	7	14.9	14.9	19.1
	4	23	48.9	48.9	68.1
	5	15	31.9	31.9	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse




Jam i kënaqur me efektivitetin e punës së sekretarisë së njësive përkatëse

Mjedisi i qëndrueshëm i punës dhe siguria për vazhdimësinë e angazhimit akademik

Rezultatet pasqyrojnë një nivel të moderuar të kënaqësisë lidhur me mjedisin e qëndrueshëm të punës dhe sigurinë për vazhdimësinë e angazhimit akademik. 36.2% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4 dhe 23.4% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke e çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 59.6%. Nga ana tjetër, 31.9% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), ndërsa 8.5% kanë dhënë vlerësimin 2, duke sugjeruar disa shqetësime. **Rezultatet tregojnë se, megjithëse një pjesë e konsiderueshme e stafit ndihen të kënaqur me qëndrueshmërinë dhe sigurinë e angazhimit të tyre, ekziston një hapësirë për rritjen e ndjesisë së sigurisë dhe stabilitetit për të përmbushur pritshmëritë e të gjithë stafit.**

Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik					
		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	2	4	8.5	8.5	8.5
	3	15	31.9	31.9	40.4
	4	17	36.2	36.2	76.6
	5	11	23.4	23.4	100.0
	Total	47	100.0	100.0	

Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik




Institucioni ofron një mjedis pune të qëndrueshëm dhe siguri për vazhdimësinë e angazhimit tim akademik

Atmosfera e përgjithshme e punës në institucion

Rezultatet tregojnë një perceptim kryesisht pozitiv lidhur me atmosferën e përgjithshme të punës në institucion. 57.4% e pjesëmarrësve kanë dhënë vlerësimin 4, dhe 31.9% kanë dhënë vlerësimin maksimal, 5, duke çuar totalin e vlerësimeve pozitive në 89.3%. Vetëm 10.6% kanë dhënë një vlerësim neutral (3), pa shfaqur pakënaqësi të theksuar. **Këto rezultate sugjerojnë se shumica dërrmuese e stafit janë të kënaqur me atmosferën e përgjithshme të punës, e cila perceptohet si mbështetëse dhe motivuese për arritjet akademike dhe profesionale.**

